



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/319
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202200424/2

Tiranë ___/___/2022

Lënda: *Rekomandim për inspektimin e kryer në ambientet e Komisarariatit të Policisë Nr.4, Tiranë.*

Drejtuar: **Z. Petrit HALA**
Shef i Komisarariatit të Policisë Nr.4

TIRANË

Për dijëni: **Drejtues i Parë Lorenc PANGANIKA**
Drejtor i Drejtorisë Vendore

TIRANË

I nderuar z. Hala,

Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës, në vijim Mekanizmi Kombëtar (MKPT), seksion pranë Avokatit të Popullit, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar dhe nenin 81 të ligjit nr. 81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", kreu një inspektim në Komisariatin e Policisë Nr.4 Tiranë.

Inspektimi u krye në datën 28.03.2022, sipas një Plani Vjetor Inspektimi të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin znj. Gloria Çarkaxhiu dhe znj. Nertila Qafzezi me detyrë nd/komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar.

Inspektimi kishte si qëllim verifikimin e respektimit të standardeve të përcaktuara në

ligjin nr.108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, procedurën standarde miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, “*Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre*”, procedurën standarde miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019, “*Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit*”, si dhe zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra gjatë inspektimit të mëparshëm.

Institucioni i Avokatit të Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues dhe nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga inspektimi i mëparshëm, ka detyrimin kushtetues dhe ligjor t’ju parashtojë konkluzionet përfundimtare, si më poshtë vijon:

Shënime të përgjithshme

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit në institucionet ku mbahen e trajtohen shtetas të privuar nga liria, grupi inspektues u takua me shefin e Komisarariatit të Policisë nr. 4 Tiranë z. Hala dhe shefin e rendit z. Artur Kullojka, të cilët u vunë në dijeni lidhur me qëllimin e inspektimit.

Në vijim, shefi i komisarariatit informoi grupin e inspektimit, për kushtet e ambienteve të shoqërimit dhe të sigurisë së këtij komisaritati, masat e marra për garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave ligjore të personave të privuar nga liria në këto ambiente, si dhe për zbatimin e rekomandimeve të institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi i mëparshëm.

Grupi i monitorimit, pasi mori informacionin e nevojshëm inspektoi ambientet e shoqërimit, zyrat e punonjësve të policisë, si dhe u njoh me dokumentacionin përkatës ku pasqyroheshin veprimet e kryera me personat e shoqëruar dhe të arrestuar apo ndaluar.

Shefi i komisarariatit dhe shefi i rendit si dhe punonjësit e policisë me të cilët kontaktoi grupi i inspektimit, u treguan bashkëpunues dhe transparentë, gjatë inspektimit në ambientet e këtij komisaritati.

Nga informacioni i punonjësve të komisariatit, si dhe nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit në inspektimin e mëparshëm¹, rezultoi se:

1. Nuk ishte realizuar rekomandimi për marrjen e masave të nevojshme për instalimin e një sistemi të monitorimit me kamera në zyrat ku merren në pyetje shtetasit e shoqëruar².
2. Nuk ishte realizuar rekomandimi për marrjen e masave të nevojshme për krijimin e ambienteve të përshtatshme ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore.
3. Ishte zbatuar pjesërisht rekomandimi për krijimin e dhomave të shoqërimit për gra dhe të mitur, por këto ambiente ishin të përshtatura dhe jo dhoma të ndërtuara sipas standardeve të përcaktuara në urdhrat e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, përkatësisht në Urdhrin Nr. 938, datë 24.07.2019, *“Rregullat dhe Procedurat Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar në Njësitë Policore”*, si dhe Urdhrin Nr. 925, datë 18.07.2019, *“Për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”*.

Ndërkohë, grupi inspektimit konstatoi se:

1. Ishte zbatuar rekomandimi për marrjen e masave që karta e të drejtave për t'u informuar për ndalimin/arrestimin të garantohet në praktikë që nga fillimi i heqjes së lirisë.

Grupi i punës në vijim inspektoi ambientet e shoqërimit, zyra e punonjësve të policisë, si dhe u njoh me dokumentacionin përkatës ku pasqyroheshin veprimet e kryera me personat e shoqëruar dhe të arrestuar apo ndaluar. Gjithashtu u verifikua nëse për personat e shoqëruar aplikoheshin pajisja e tyre me “Procesverbalin e Shoqërimit”, ku rezultoi se ky standard ligjor realizohej për të gjithë shtetasit e shoqëruar.

¹ Rekomandimi i dërguar me nr. K4/I11-2 prot., datë 16.07.2021.

² *“Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standardeve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu; kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohej që të regjistrohet në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkesë të bërë nga i ndaluari gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste.” Raporti i CPT-së për Armeninë: CPT/Inf (2016) 31 [par.20]*

Gjatë inspektimit u konstatua se, në Komisarlatin e Policisë nr. 4 kishte 1(një) dhomë shoqërimi për persona të rritur, 1(një) ambient i përshtatur në katin e parë për të mitur dhe 1(një) ambient i përshtatur për gra. Në këtë komisarlat nuk ka ambiente sigurie.

Në këtë Komisarlat **nuk administrohej** regjistër për të miturit të shoqëruar në konflikt me ligjin ku të evidentoheshin të gjithë rastet e të miturve të shoqëruar në këto ambiente. Ky fakt vjen në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr. 37/2017 “*Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur*”.

Në përfundim të inspektimit grupi monitorues konstatoi se, në ambientet aktuale në Komisarlatin e Policisë nr. 4 në Tiranë, vazhdonin të ishin të pranishme disa problematika dhe konkretisht:

Ambientet e shoqërimit dhe kushtet e tyre:

Sipas informacionit të grumbulluar në vend gjatë kryerjes së inspektimit, **rezultoi se gjendja konkrete e ambienteve të shoqërimit ishte e ngjashme si në inspektimin pararendës**, ballafaquar me standardet e parashikuara në aktet normative dhe dokumentat ndërkombëtare, për respektimin e të drejtave të personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar brenda këtyre ambienteve.

Në Komisarlatin e Policisë Nr.4 ambientet e shoqërimit të tërësi **nuk ishin** të ndërtuara sipas parashikimeve të bëra në ligjin Nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar dhe në procedurat standarde: miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr.938, dt. 24.07.2019, “*Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit*”.

Nga këto ambiente 1(një) dhomë shoqërimi për persona madhorë meshkuj ishte me hapësirë të bollshme për qëndrim, por theksojmë se mungonin tavolina dhe karriget, në këtë dhomë kishte vetëm një stol. Për sa i përket dy dhomave të tjera, përkatësisht dhoma për gra nuk ishte e lyer, kishte karrige por jo tavolinë dhe as hapësirën e duhur, ndërkohë që dhoma për të mitur ishte e pastër dhe e lyer rishtazi, e pajisur me orënditë e nevojshme si tavolinë dhe karrige për qëndrimin ulur me kushte për trajtim dinjitoz të të shoqëruarve. Këto dy dhoma nuk ishin ambiente të ndërtuara sipas standardit të kërkuar pasi nuk kishin hapësirën e duhur.

Këto dhoma shoqërimi me kapacitet maksimal prej 9 (nëntë) personash ndodheshin në katin e parë të ndërtesës së këtij komisarlati, kishin dritare të cilat lejonin ajrimin dhe ndriçimin natyral, si dhe kishin ndriçim nga rrjeti elektrik, dhomat kishin edhe burim rezervë energjie me gjenerator.

Dhoma e shoqërimit nuk kishin tualet brenda, për të shoqëruarit tualetet, ndodheshin në korridorin e ambientit të shoqërimit. Në këtë komisariat **kishte sistem monitorimi me kamera** për mbajtjen në vëzhgim të korridorit të ambientit të shoqërimit. Në kohën e kryerjes së inspektimit nuk kishte persona të shoqëruar.

Në Komisarlatin e Policisë nr.4 Tiranë, gjatë periudhës 01.01.2022 deri më 28.03.2022 ishin të shoqëruar, të ndaluar apo të arrestuar dhe të evidentuar në regjistrin e shoqërimit **422** persona, nga të cilët 33 gra dhe 9 të mitur sipas përcaktimeve të bëra përkatësisht në nenin 109 “*Shoqërimi në polici*” dhe në paragrafin 1 të nenit 112³ “*Të dhënat në rastet e shoqërimit, ndalimit dhe arrestimit*” të ligjit nr. 108/2014 “*Për Policinë e Shtetit*” i ndryshuar.

Gjithashtu, na informuan se personat e shoqëruar nga policia janë të informuar për të drejtat e tyre, që nga fillimi i privimit të lirisë, duke siguruar dhënien e kartës së të drejtave në formë shkresore që në momentin e hyrjes në Komisarlat⁴.

Ambientet e sigurisë dhe kushtet e tyre

Në Komisarlatin e Policisë Nr.4 nuk kishte ambiente të sigurisë dhe personat e arrestuar/ndaluar dërgoheshin në dhomat e sigurisë të Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë.

Regjistri i personave të shoqëruar si dhe trajtimi i të shoqëruarve, ndaluarve/arrestuarve gjatë veprimeve që kryen policia.

Gjatë inspektimit u konstatua se në Komisarlatin e Policisë Nr.4, “*Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar*” ishte i tipit “*Model nr. 1*” konform me procedurat standarde miratuar me Urdhrin nr. 938, dt. 24.07.2019 të Drejtorit të

³ Paragrafi 1 i nenit 112 parashikon: “*Për të regjistruar nga ana administrative të dhënat e personave të shoqëruar, të arrestuar apo të ndaluar, policia kryen këto veprime: 1. Në rast shoqërimi, policia evidenton për çdo person të shoqëruar të dhënat për: a) gjenealitetet; b) vendbanimin; c) përshkrimin e pamjes së personit, përfshirë shenja të veçanta; ç) punën që kryen; d) arsyet e shoqërimit; dh) orën, datën dhe vendin e shoqërimit; e) zyrën e policisë ku është kryer shoqërimi; ë) punonjësin e policisë, i cili ka kryer shoqërimin.*”

⁴ CPT u bën thirrje autoriteteve shqiptare të ndërmarrin hapa për të siguruar që personat e ndaluar nga policia të jenë plotësisht të informuar për të drejtat e tyre që nga fillimi i heqjes së lirisë (domethënë, nga momenti kur ata janë të detyruar të qëndrojnë në polici).

Kjo duhet të sigurohet me dhënien e informacionit të qartë verbal që në fillim, për t'u plotësuar në rastin më të shpejtë (domethënë, menjëherë pas mbërritjes në ambientet e policisë) me sigurimin e fletës së informacionit të lartpërmendur. Personave në fjalë duhet t'u kërkohet të nënshkruajnë një deklaratë që vërteton se ata kanë marrë një kopje të fletës së informacionit.

Raporti CPT-së për Shqipërinë CPT/Inf (2019) 28 [par.24]. Konsulto: <https://rm.coe.int/168097986b>.

Përgjithshëm të Policisë së Shtetit “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, dhe ishte i sekretuar. Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të parashikuara në ligjin nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit.

Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se:

Koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi të shtetasve ishte e ndryshme nga 1 deri në 10 orë në raste të veçanta. Rubrikat e regjistrimit **ishin plotësuar në mënyrë korrekte**, me përgjegjësi dhe saktësi nga punonjësit e policisë⁵.

Për rrjedhojë u konstatua se ishte plotësuar standardi për pasqyrimin me saktësi dhe përgjegjësi të rubrikave të librit të shoqërimit nga punonjësit e policisë të zyrës së informacionit.

Në këtë komisariat kishte regjistër për personat e ndaluar/arrestuar, ku evidentoheshin të gjitha rastet e ndalimeve dhe arrestimeve të kryera nga punonjësit e këtij organi, i cili ishte i sekretuar. Ky regjistër ishte i plotësuar me korrektësi në të gjitha rubrikat e tij.

Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se në rastet e arrestimeve dhe të ndalimeve të personave të shoqëruar, ora e arrestimit/ndalimit përputhej me orën e shoqërimit të tyre në organin e policisë. Personat e arrestuar/ndaluar dërgoheshin në dhomat e sigurisë të Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë.

Ndërkohë u konstatua se në këtë komisariat **nuk administrohej regjistër** për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 115 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar. Sa më sipër përbën cënim të standardit të parashikuar në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 925, datë 18.07.2019, “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, përkatësisht në Kreun XV “Procedurat për evidentimin dhe trajtimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të ndaluar dhe të arrestuar”, pika 5.1 gërma “c”⁶.

⁵ Kreu VIII, “Procedura të Dokumentimit të Veprimit të Shoqërimit” parashikuar me Urdhrin Nr. 938, dt. 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shteti “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”.

⁶ Punonjësi i policisë që merr ankesë/kërkesën e pasqyron atë në regjistrin e ankesë/kërkesave sipas rubrikave përkatëse, si dhe nënshkruan për këtë gjë në rubrikën përkatëse të regjistrimit.

Ambientet e intervistimit

Në Komisarjatin e Policisë Nr.4 oficerët e policisë gjyqësore i kryenin veprimet procedurale me shtetasit në zyrat e tyre. Këto zyra nuk ishin të monitoruara dhe ndërkohë në këtë organ nuk kishte ambiente të veçanta intervistimi të monitoruara me kamera gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore⁷.

Lidhur me këtë fakt Avokati i Popullit nisur edhe nga inspektimi i mëparshëm ka rekomanduar marrjen e masave për krijimin e zyrave të dedikuara ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto **zyra por është konstatuar se sërish rekomandimi nuk është plotësuar.**

Avokati i Popullit, duke iu referuar standardeve ndërkombëtare, e konsideron procesin e monitorimit filmik një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit.

Nga monitorimi që u bë në disa prej zyrave të punonjësve të policisë, **nuk u gjetën sende, prania e të cilave të ekspozonte dhunë** tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale.

Ndihma juridike dhe psikologjike

Nga pyetja e punonjësve të policisë rezultoi se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit madhorë të cilët nuk kishin mundësi financiare për të pajtuar avokat privat dhe kërkonin ndihmë juridike, atyre iu sigurohej mbrojtja me avokat⁸.

⁷ “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standardeve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu; kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohet që të regjistrohen në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkësë të bërë nga i ndaluarit gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste.” Raporti i CPT-së për Armeninë: CPT/Inf (2016) 31 [par.20].

<https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016806bf46f>

⁸ CPT ka rekomanduar se duhet të bëhen përpjekje të mëtejshme për të siguruar që e drejta për t’u informuar për ndalimin/arrestimin të garantohet në praktikë që nga fillimi i heqjes së lirisë. Sipas nenit 255/4 të Kodit Penal, policia informon familjen e personit të ndaluar/arrestuar pa vonesë. CPT ka rekomanduar që oficerët e policisë duhet të kenë parasysh që të lejojnë të ndaluarit/ arrestuarit të kenë qasje tek një avokat (e drejta për të pasur një avokat privat, të flasin me të dhe të jenë të pranishëm gjatë marrjes në pyetje) që nga fillimi i heqjes së lirisë dhe të garantojnë në praktikë këtë e drejtë. **Raporti CPT-së për Shqipërinë CPT/Inf (2019) 28 [par.21].** Konsulto: <https://rm.coe.int/168097986b>

Në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet proceduriale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht dhe të psikologut. Avokatët siguroheshin nga lista e avokatëve të dërguar nga organi i prokurorisë, ndërsa psikologu sigurohej nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë Tiranë.

Gjatë inspektimit u konstatua se në korridoret e godinës dhe të ambientit të shoqërimit ishin afishuar postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar në organin e policisë dhe të personave të ndaluar/arrestuar, por përsëri nuk sigurohej qasja e të shoqëruarve në këto postera pasi ata janë në kalim e sipër.

Ndërkohë u konstatua se në këtë komisariat zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenet 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VIII, pika a.3.4 të procedurave standarde për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse.

Sipas parashikimeve të K.Pr.P., përkatësisht në paragrafin 2 të nenit 34/b “*Të drejtat e personit të arrestuar ose të ndaluar*”⁹ si dhe në paragrafin 4 të nenit 251¹⁰ “*Arrestimi në flagrancë*” parashikohet se të ndaluarit/arrestuarit duhet t’i jepet dhe të mbajë me vete një kopje të procesverbalit të ndalimit/arrestimit. Rezultoi se ndaj personave të shoqëruar nga punonjësi i policisë mbahej një procesverbal tip i emërtuar “*Formulari i raportit të Shoqërimit ose Ndalimit/Arrestimit*”.

Përfundimisht theksojmë se problematikat e evidentuara gjatë këtij inspektimi janë trajtuar edhe në rekomandimet e mëparëshme drejtuar institucionit të Komisarariatit të Policisë Nr. 4 dhe për rrjedhojë në vijim do të vazhdojmë të kërkojmë informacion lidhur me plotësimin e tyre.

Për sa më sipër dhe me qëllim zgjidhjen e problemeve të konstatuara gjatë këtij inspektimi, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të*

⁹ Paragrafi 2 i nenit 34/b parashikon: “*Organi procedues e njofton menjëherë personin e arrestuar ose të ndaluar për të drejtat e parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh” dhe “e”, të paragrafit 1, të nenit 34/a, të këtij Kodi, duke i dhënë, kundrejt nënshkrimit, letrën e të drejtave në formë të shkruar. Personi ka të drejtë ta mbajë letrën e të drejtave.*”

¹⁰ Paragrafin 4 i nenit 251 parashikon: “*Në rastet e parashikuara nga paragrafi 1, çdo person është i autorizuar të kryejë arrestimin në flagrancë për krimet që ndiqen kryesisht. Ai që ka kryer arrestimin duhet të dorëzojë menjëherë të arrestuarit në policinë gjyqësore, e cila mban procesverbal për dorëzimin dhe i jep një kopje të tij.*”

drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike” dhe në bazë të nenit 21/b të ligjit nr. 8454 dt.04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”,

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave të menjëhershme për ndërtimin e ambienteve të shoqërimit, sipas kushteve dhe kritereve të parashikuara në procedurat standarde miratuar me Urdhrin nr. 938, datë 24.07.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit “*Rregullat teknike të shoqërimit në polici*”, **duke krijuar ambiente të përshtatshme, dinjitoze, të pajisura me orenditë e nevojshme për qëndrim, të ndara më vete duke respektuar standardet për femra, meshkuj dhe të mitur.**
2. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e ambienteve të përshtatshme ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore.
3. Marrjen e masave të nevojshme për instalimin e një sistemi të monitorimit me kamera në zyrat ku merren në pyetje shtetasit e shoqëruar.
4. Marrjen e masave të menjëhershme për pajisjen me regjistrat përkatës sipas legjislacionit në fuqi, përkatësisht një regjistër për evidentimin e të dhënave për personat e shoqëruar të mitur, si dhe një regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave për mbrojtjen efektive të të drejtave të personave të privuar nga liria lidhur me kushtet e qëndrimit dhe trajtimin që u bëhet nga personeli policor.
5. Marrjen e masave administrative në lidhje me mungesën e regjistrit për të mitur dhe regjistrin të kërkesë/ankesave.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

KOMISIONER

Ahmet PRENÇI